

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 28.05.2021

Prot. 36 (tridhjetëegjashtë)

Protokoll nr. 36

I mbajtur sot më datë 28.05.2021, në mbledhjen e radhës sw Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00, (online),

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2022;
3. P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2021”;
4. P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”;
5. P-V “Për fillimin e procedurave të zhvendosjes së familjeve që jetojnë pranë ish-Komititetit dhe strehmit të tyre në godinën e ish-Laboratorit Qendror si dhe përcaktimin e qirasë për çdo banesë dhe përbërjen familjare”;
6. P-V “Për rishikimin e buxhetit të bashkisë pwr vitin 2021”;
7. P-V “Për miratimin e Raportit të Monitorimit 4-mujor, viti 2021”;
8. P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2021 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturat e saj, për vitin 2021”;
9. P-V “Për miratimin e Dokumentit të Vlerësimit të Riskut në Bashkinë Maliq si dhe Strategjinë Operacionale për Zvogëlimin e Riskut nga fatkeqësitet”;
10. P-V “Për vendosjen të emrit të shkollës së fshatit Zerec “Shaban Maranaku” (Zereci), shkollës së fshatit Popçisht “Shahin Matraku” dhe vendosjen e bustit në qendër të fshatit Moglicë të “Hasan Bardhit” (Moglica);
11. Informacion mbi rezultatet e Konsultimit Publik online për përcaktimin e prioriteteve të Komunitetit të PBA-sw, viti 2021-2023;
12. Informacion mbi gjetjet e anketimit për punën e kryer nga Këshilli Bashkiak gjatë vitit 2020;
13. P-V “Për miratimin paraprak të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Maliq”;
14. Prezantimi i Raportit të Performancës për Bashkinë Maliq, viti 2020.
15. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; File Qyrani; Kujtim Demollari; Floreta Zaçe; Evisa Demollari; Fevri Sherifi; Klement Zere; Aldi Mullalli; Tefik Meçollari.
10 (dhjetë) këshilltarë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarë online në platomën ZOOM: Kristina Malelli; Kristiana Jonusllari; Rexhina Hëna; Jonilda Koçllari; Armando Dautllari; Fatjon Brahimllari; Valentina Pashollari; Idlir Limllari; Dorjan Zholi. 10 (dhjetë) këshilltarë

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu; Dr. i Shërbimit Social z.Azem Nuhu; Dr.Shërbimit Pyjor z.Marsel Nazifi; P/Emergjencave Civile z.Stiljan Belishta; P/Sektorit të Strehimit z.Ledion Mullalli.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë kweshilltarë, i nderuar Kryetar i Bashkisë, ju përshëndes të gjithëve, fillojmë me mbledhjen e Këshillit të Bashkisë me rend ditë prej 15 pikash bashkë me diskutime të tjera. Me rendin e ditës dhe materialet jeni njohur më parë, para se të fillojmë do bëj një verifikim të korumit të mbledhjes, 10 këshilltarë na ndjekin online dhe 10 anëtarë këshilli janë prezent në sallë, kështu bëhem 20 anëtarë këshilli nga 31 që jemi në total. Kështu që korumi plotësohet, mund të vazhdojmë mbledhjen.

E miratojmë rendin e ditë si fillim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet rendi i ditës.

Pika tjetër është miratimi i proces-verablit të mbledhjes së datës 30.04.2021, tre janë vendimet të cilat kanë gjetur dakortësinë e Prefektit dhe janë kthyer nga P-V në Vendime. (*lexon vendimet e datës 30.04.2021*)

- Vendim nr.25 “Për dhënie mandati të Këshilltarit zj.Evisa Demollari”

- Vendim nr.26 “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% te fondit për muajin mars 2021”;

- Vendim nr.27 “Për rishikim të buxhetit të Bashkisë Maliq viti 2021”, gjithashtu te kjo pikë kemi protokollin e mbledhjes së kaluar.

E miratojmë protokollin e mbledhjes të kaluar?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet.

Pika tjetër e rendit të ditës është pika e 3-tw, P-V “Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% te fondit për muajin prill 2021”, wshtë një pikë që ne e kalojmë gjithmonë, ka ndonjë pyetje për këtë?

Valentina Pashollari: Me lejë Kryetar?

Ornildi Demollari: Po Vali, kishe diçka?

Valentina Pashollari: Doja të pyesa Drejtorin e Shërbimit Social, pse disa në listë kanë rimbursimi të energjisë elektrike dhe disa jo?! Është përfaktin që nuk kanë kontratë të energjisë elektrike, apo ka ndonjë problem tjetër?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Dr. i Shërbimit Social z.Azem Nuhu: Po Vali të gjitha ato familje që kanë një kontratë e përfitojnë kompesimalin njëloj si familjet që përfitojnë ndihmën në sistem, ato familje që nuk kanë kontratë nuk mund të përfitojnë kompesimalin.

Ornildi Demollari: E qartë?

Dr. i Shërbimit Social z.Azem Nuhu: Është e njëjtë procedurë si në sistem.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë problem tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, faleminderit!

Kalojmë tek pika tjetër rendit të ditës, pika e 4-t, P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë”, kush e do fjalën?

Pranvera Begolli: Përshëndetje Kryetar! Kam parë materialin dhe Relacionin shpjegues, por do doja brenda mundësive, Anxhela Sulejmani është një nuse e re që jeton në bllokun nr.3 Maliq, është nga komuniteti rom dhe është vërtet me një sëmundje të keqe, vlera t'i shkojë në 50.000 lekë n.q.s. ka mundësi? Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Kërkesa të tilla mund të ketë nga të gjithë, ajo çfarë duhet të bëjë çdo këshilltar, është që të bëjë një rakordim me Drejtorinë e Shërbimit Social në bashki për të parë situatën financiare, për të sjellë diagnoza dhe dokumenta të tjera shoqëruese, pasi problematika të tilla ka kudo. Ajo çfarë ne duhet të bëjmë është t'i seleksionojmë, t'i shkojmë si raste të emergjencave civile apo të shërbimit social për t'ju dhënë një zgjidhje. Kështu që do ju sugjeroja qw rasti në fjalë t'i kalohet Shërbimit Social për ta parë, megjithëse mundësitë financiare që kemi si organ ekzekutiv bashkë me Këshillin Bashkiak në këtë zë po shkojnë drejt fundit. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër?

Valentina Pashollari: Me lejë Kryetar?

Ornildi Demollari: Po Vali,

Valentina Pashollari: Mbledhjen e kaluar diskutuan për një grua në Podgorie që e ka bashkëshorit në burg në Greqi dhe ka tre fëmijë dhe është në proces divorci, i është dhënë ndonjë zgjidhje?

Dr. i Shërbimit Social Azem Nuhu: Kam biseduar, situata u zgjidh, u sigurua vërtetimi i burgut të bashkëshorit. Problemi u zgjidh sepse vetëm vërtetimi mungonte në dosje.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e katërt me 20 vota pro, faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetar je gati për prezantimin? Do doja që pikën e prezantimit të Programit të Performancës të Bashkisë Maliq për vitin 2020 të cilën e kemi pikën nr.14, ta kalonim tanë pikën nr.5, se ndoshta zgjat pak, gjithmonë me dakordësinë tuaj. Jeni dakord që pikën e 14-tw ta diskutojmë tanë? Kryetar ke fjalën.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Përvendetje të gjithwve, të nderuar qytetarë, të nderuar këshilltarë, është një nga pikat më të rëndësishme të Bashkisë Maliq për një vit buxhetor, prezantojmë performancën e institucionit për vitin kalendarik 2020, edhe pse ka qenë një vit i vështirë përfekt të pandemisë.

Bashkia Maliq është munduar të ruajë të njëjtin trend përfunduar të gjitha shërbimet ndaj komuniteti por jo vetëm dhe detyrimet ligjore që kanë bëjnë me të gjitha aspektet si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet, këtu dua të falenderoj “Bashki të Forta” që ka bërë të mundur që edhe gjatë këtij viti të prezantojmë një Rapor Performance jo vetëm përfundon tonë por veçanërisht përfunduar qytetarët të cilët tashmë në faqen e bashkisë kanë një informacion se cilat janë të ardhurat, shpenzimet, ku shkon çdo lekë që ata paguajnë apo qeveria qendrore jep përfekt të menaxhimit të institucionit të Bashkisë Maliq.

Në pamje të parë dua të nënvízoj që jemi pothuajse në të njëjtat nivele si të ardhurave dhe shpenzimeve, me lëvizje të vogla pavarwsisht viti të vështirë buxhetor përfekt të pandemisë. Në totalin e përgjithshëm të ardhurat e financaura gjatë vitit 2020 shkojnë gati 79.8% pothuajse barazim me një vit më parë që ishin 80.6%, ku të ardhurat e qeverisë qendrore, si në çdo vit kapin peshën më të madhe krahasuar me të ardhurat e veta.

Në totalin e përgjithshëm 80% janë transfera të pakushtëzuara apo të kushtëzuara në varësi të shpenzimeve apo të funksionove që ne mbulojmë, pjesa tjeter 20% janë të ardhurat tona nga taksat, tarifat vendore apo të trashëguara nga një vit më parë. Në të gjithë burimet e financimit që Bashkia Maliq ka menaxhuar ato shkojnë me planin në masën 84% në vitin 2020.

Bashkia vazhdon të ketë pwrqindje më të madhe nga qeveria qendore, edhe në këtë pikë ne duhet të shohim mundësinë që të bëhem më shumë të pavarur duke mbledhur më shumë taksa dhe tarifa. Po të bëjmë një krahasim me vitin 2020 dhe të ardhurat dhe shpenzimet lëvizin me shifra të vogla me ato që ju kemi prezantuar në material.

Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë në vitin 2020 kanë një rritje me 2019 me 6% dhe në tarifat lokale kjo shkon deri në 11% me një shtesë prej 5% midis dy niveleve të taksave dhe tarifave vendore. Në totalin e përgjithshëm realizimi i shpenzimeve buxhetore kap shifrën 82%, kjo vjen përsye se disa nga investimet e fundvitit janë fatura që ngelen përfillimivit 2021, këto investime janë në proces. Këto investime tregojnë se puna e bashkisë është me rritje të kënaqshme, duke realizuar një punë voluminoze nga njëri vit te tjetri.

Në tabelë e keni të ndarë me zëra (Ujitje-Kullimi, Uji i pijshëm) n.q.s. ka ndonjë pyetje nga këshilltarët, apo ata që e ndjekin në kohë reale, dua të them disa fjalë lidhur me shpenzimet buxhetore. Shpenzimet buxhetore përfunduar 2020 kanë shënuar një rritje krahasuar me ato të vitit 2019 në masë 4%, ndërkokë që realizimi i tyre kunddrejt planit të vitit 2020 ishte 82%, ashtu si e thashë pak më lart. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh ndaj komunitetit falw edhe decentralizimit që qeveria qendrore ka dhënë përfunduar lokal. Dua të nënvízoj Kujdesin Social që është një nga drejtoritë më të rëndësishme që mbulan dhe një nga



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

shpenzimet më të mëdha nga fondet e kushtëzuara të destinuara vetëm për familjet në nevojë apo shtresat e tjera.

Nga ana tjetër shpenzimet kanë të bëjnë me planifikimin dhe menaxhimin administrativ, shërbimet publike vendore, Arsimi bazë dhe ai parashkollar, rrjeti rrugor, menaxhimi i ujitje-kullimit, furnzimi me ujë, mbrojtja nga zjarri, emergjencat civile, janë shërbime të cilat bashkia prej disa vitesh i menaxhon dhe besoj qytetarët kanë ndjerë tashmë dorën e pushtetit vendor, shërbimin tonë të cilin kohë më parë nuk e kishin.

N.q.s. flasim vetëm për një sektror, siç janë Emergjancat Civile, dua të them, apo dhe Mbrojta nga Zjarri dhe Shpëtimi, n.q.s. një vit më parë ky shërbim kryhej me ndihmën e Shërbimit Zjarrfikës që ishte në qytetin e Korçës, tani është një nga shërbimet më të shpejta dhe qytetarët tani e kanë ndjerë dhe është një nga shërbimet tonë më të mira dhe në qarkun e Korçës dhe besoj se do ketë përmirësimë dhe në të ardhmen. E njëjtë gjë ndodh dhe me Rrugët Rurale, me Ujitje-Kullimin. Informacioni është shumë i gjërë, nuk dua të hyj e të bëhem i dëshiruar që ishte një përmirësim i rëndësishëm. Në qendër të rëndësishëm është që gati 700 km kanale kullues dhe vaditës në fushën e Malit të Zi janë pastruar dhe d.m.th. shkojmë në një nivel 80-90% të gjithë kanalizimeve dhe po kthehem duke bërë pastrimin e kanaleve që kemi bërë në fillim pasi ka krijuar mbushje.

Qytetarët dhe fermerët i kanë rritur kërkesat e tyre dhe bëjnë shumë mirë, ne na venë në pozita pune që çdo kanal kullues dhe vaditës e tashmë është dhënë dhe efekti që fusha e Malit të Zi nuk ka më përmbytje dhe ky është një element shumë i rëndësishëm.

Nga ana tjetër n.q.s. e shkojmë shpenzimet përfshirë efektin e natyrës ekonomike në vitin 2020 ne kemi planifikuar 115 milion lekë të reja investime dhe rrëth 137 milion lekë janë shpenzime koherente, shpenzimet janë më të mëdha pasi hynë të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë që nga mirëmbajtja e objekteve shkolllore, nga ngrohja, uji, ndriçimi publik, etj.

Nga ana tjetër në vitin 2020 realizimi shkon rrëth 109 milion lekë, atë që thamë ka një mospërputhje të vlerës 100% midis planit dhe faktit përfshirë efektit të investimeve të cilat realizohen në muajt e parë të vitit përfshirë që përfshirë që një objekti apo dhe të pagesave të faturave të cilat janë normale në menaxhimin e institucionit. Krahasimet ju i keni dhe me vitet e tjera, realizimi në totalin e përgjithshëm përfshirë investimet është në masën 90% një shifër e konsiderueshme, një shifër nga më të mirat në Shqipëri, pasi niveli i realizimit të investimeve po të shohim institucionet e tjera kjo shifër është e ulët. Mund të them disa fjalë në lidhje me investimet, kemi investuar në shumë drejtime, peshën më të madhe ja kemi dhënë rrugëve, kanalizimeve, ujët të pijshëm, tre nga elementët kryesorë të asaj që ne kemi gjetur nga shqetësimet e banorwve, nga dëgjesat që kemi bërë me grupet e interesit dhe besoj se efketet janë të dukshme në të gjitha njësistet administrative dhe në shumicën e fshatrave ku tashmë është ndjerë dora e bashkisë në rrugë, kanalizime, ujësjellwsa dhe institucione arsimore. Vetëm në vitin 2020 ne kemi ndërrhyruar në gati 22 objekte arsimore, të cilat kishin nevojë përfshirë ambienteve apo shërbimeve, si ngrohje, tualete, etj. Pesha e tyre në buxhetin e bashkisë në vitin 2020 zë 11% nga 14% që ka qenë në vitin 2019. Në fakt viti 2018 dhe 2019 po ta shohim ka një peshë më të madhe në investime, jo përfshirë që ne kemi mbuluar nga të ardhurat tonë, se nga pesha më e madhe që buxheti qendror na ka dhënë disa akse kryesore, siç janë akset kryesore në Vreshtas, Orman, Rrëmbec, Pojan, janë rrugë të cilat tashmë janë një realitet përfshirë gjithë komunitet tonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në të njëtën kohë ne nuk kemi ulur vëmendjen e investimeve dhe në sport, dhe në përmirësimin e tereneve, lulishteve të cilat kanë filluar të kërkohen nga banorët pasi me të drejtë pasi duke qenë se ne kemi vendosur një tarifë minimale për ndriçimin publik, gjelbërimin, për shërbimin ndaj varrezave, etj. minimalisht kemi detyrimin ndaj qytetarëve që këto fonde të shkojnë dhe në këto drejtime shumë të rëndësishme. Po ta shikoni tabelën e tregueswve finanziarë atje tregon një punë të kënaqshme, mund të shikoni në njw vend dy shigjeta të kuqe, që kanë pësuar ulje me 2019-wn, por siç thashë është që qeveria qendrore në një vit ka investuar më shumë nw një vit, kjo në varësi dhe të politikave rajonale dhe kombëtare që aplikon.

Dy fjalë në lidhje me treguesit finanziarë, jepin një menaxhim të fondevë publike dhe po ju them me vetëdije të plotë që ka një menaxhim shumë korrekt nga Bashkia e Maliqit në menaxhimin e fondevë buxhetore, këtu po sjell në vëmendjen tuaj dhe kontrollin e fundit të KLSH-sw që ka bërë te bshkia jonë dhe si asnjëherw tjeter për pjesën financiare kemi marrë një vlerwsim pozitiv, që do të thotë edhe pse KLSH në totalin e përgjithshëm hyn në institucionë që vetëm bëjnë vëretje për efekt të përmirësimit të punës, për treguesit finanziarë kemi marrë një vlerwsim shumë pozitiv dhe kjo është me të vërtetë wshtë shumë ambicioze për punën tonë në të ardhmen.

Atë që dua të deklaroj ka të bëjë dhe me prokurimin e fondevë publike që ne bëjmë disa herë, në çkuptim? N.q.s. Këshilli i Bashkisë ka miratuar në fillim të vitit një fond për një rrugë, x lekë nga ulja e prokurimeve që ndodhin atë vit ne e prokuromë për një herë të dytë, që ajo rrugë nga një gjatës x metra të shkojë deri në gjatësi përfundimtare apo më të madhe nga sa ishte planifikuar në fillim. Pse nuk e kemi planifikuar që në fillim? Por fononet nuk na i lejojnë këtë mundësi, nevojat janë më të mëdha se mundësitet tona financiare për t'i realizuar të gjitha ato çfarë thashë më lart.

Atë çfarë dua të nënvisojoj ka të bëjw dhe me disa funksione të tjera që kanë pësuar rritje siç është rritja e mbështetjes për Shërbimet Sociale, rritje e peshës që zenë të ardhurat e bashkisë për efekt të burimeve të financimit, ulja e peshës së investimeve dhe rënia e peshës së shpenzimeve koherente për mirëmbajtje në tërësinë e buxhetit të bashkisë. Nga ana jonë është parë me kujdes, nga ana tjeter ekzekutimi i buxhetit mbetet në të njëjat nivele si një vit më parë, që do të thotë që ne kemi krijuar një konsolidim të financave, megjithëse atë çfarë unë dua të nënvisojoj, dua ta bëj edhe publike për këshilltarët, veçanërisht për qytetarët, ne duhet të jemi më kërkues në vjeljen e taksave dhe tarifave vendore për tw arritur maksimumin e mundshëm, duke luftuar informalitetin nga njëra anë dhe duke synuar uljen e taksave dhe tarifave vendore në momentin që realizojmë një mbledhje më të përgjithshme. Është e vërtetë që sa më shumë të ardhura ne të grumbullojmë aq më shumë shërbime do të kryejmë dhe kjo na jep mundësinë që me vendimarrjen që Këshilli i Bashkisë merr çdo fillimviti të bëjmë të mundur një kategorizim apo një ulje të taksave dhe tarifave vendore atje ku ligji na lejon edhe pse në totalin e përgjithshëm ne 30% të taksave dhe tarifave ku na ka lejuar ligji ne i kemi ulur me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Administrimi i Bashkisë, po ta shikoni, pesha ndaj totalit, e keni në tabelë përkatëse, kap 15%, realizimi i faktit shkon 87%, vlera në mijë lekë shkon rrëth 152.266, është realizimi faktik i vitit 2020. Keni të ndara dhe shpenzimet koherente dhe shpenzimet për investime sipas miradiministrimi për efekt të administratës, është vlera më e ulët ndër vite, ne nuk është se shpenzojmë shumë lekë për funksionimin e administratës, funksionojmë në momente të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

caktuara për blerje pajisje, si printera, kompjutera, të cilat kanë një vlerë amortizimi. Shpenzohet shumë pak lekë për pajisje që ne shpesh i shohim si shpenzime luksi. Në këtë drejtim po ta shikoni tabelën atje e kapin investimet që kanë të bëjnë direkt me komunitetin si rrugë, kanalizme, ujësjellwsa që kapin një vlerë prej 43 milion lekë të reja. Investime të tjera në vitin 2019 kapin 50 milion, atë çfarë unë dua të nënvizoju edhe pse këtu duket 4 milion lekë ka të bëjë me pjesën administrative të bashkisë. Bashkia ka realizuar shpenzime edhe për shërbimet mbështetëse, si Drejoria e Shërbimit Publik, e cila është një nga drejtoret nga më të mëdha që kemi dhe mbulon një gamë të gjerë shërbimesh, veçanërisht në institucionet arsimore edhe shëndetësore kemi bërë ndërhyrje, se dhe udhëzimi i Minsitrisë së Financave na i lejon në momente kur kemi mundësi për të bërë përmirësimë të mundshme në institucionet shëndetësore, kemi ndërhyrë për rregullime.

Në lidhje me performancën në marrëdhënie me komunitetin, edhe këtu ka një përmirësim edhe “Bashki të Forta” por jo vetëm na kanë ndihmuar që ne të jemi në çdo rast online të qytetarët për atë çfarë ndodh në Bashkinë e Malit. Vërtet është diçka shumë pozitive dhe vlen për t'u falenderuar, ka një rritje kapaciteti në administratën e bashkisë ka një përmirësim, është rritur numri i tajnimeve për punonjësit tanë pasi në këtë pikë kemi shumë nevojë. Ndaj trajnimet me “Bashki të Forta” por jo vetëm Minsitria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, OJQ të tjera na kanë bërë që kemi një përmirësim të dukshëm që hartimi i projekteve dhe deri në elementë të tjerë që kanë të bëjnë me performancën e bashkisë.

Shërbimi Social, ndihmat për familjet në nevojë kanë qenë një element shumë i rëndësishëm edhe në vitin 2020, realizimi në këtë zë është 100% në asnjë rast ne nuk ka qenë problematikë në pagesa edhe kwshilli ka qënë shumë i saktë në vendimmarrjet e tij në kohë, edhe për këtë dua t'i falenderoj anëtarët e Këshillit të Bashkisë për vendimmarrjet që na janë dashur pasi situata e pandemisë na i ka vështirësuar pak punën, por takimet online kanë bërë që vendimmarrjet të meren në kohë pagesat po ashtu dhe qytetarët të marrin 100% të fondeve që qeveria qendrore ka parashikuar. Pesha ndaj totalit kap 43% edhe në vlerë, në mijë lekë e keni në tabelën përkatëse.

Bashkia ka realizuar shpenzime dhe ofrim shërbimi për familjet në nevojë me pagesa ekstra nga fondet rezervë apo fondet të parashikuara nga ana jonë për raste të veçanta siç mund të jenë edhe vendimmarrjet që Këshilli i Bashkisë ka marrë edhe në ditën e sotme. Në çdo rast e kemi parë me kujdes që të bëjmë një trajtim sa më real për rastet të cilat vërtet kërkojnë mbështetje. Arsimi bazë, arsimi parashkollar pesha ndaj totalit është 9%, është një shifër jo e pakët, por ne duhet të synojmë që në arsim të investojmë më shumë. Po të shohim objektivat, treguesit e performancës i keni sipas viteve 2018-2019 dhe fakti 2020 jemi në të njëjtat nivele. Raporti i shpenzimeve ka një rritje po ta shikoni nga 1192 që është fakti në 2020 është 1393 me një planifikim 1877 mijë lekë, po edhe këtë mund ketë disa fatura që do paguhen në vitin 2021.

Në një farë mënyrë tabela flet vetë është ulur frekuentimi i arsimit parashkollar, kjo për një sërë faktorësh, nuk është se mungon shërbimi i bashkisë, por lëvizjet demografike, lëvizjet e tjera kanë bërë që të ketë një ulje, jo në masë të konsiderueshme. Është rritur norma mesatare e nxënsve në klasë dhe mësuesve. Në politikat që Ministria e Arsimit po bën veçanërisht në arsimin parashkollar, tashmë ne kemi detyrim që për 15 fëmijë kopshti të kemi një edukatore. Kemi hapur kopshte dhe në zona të thella ku një vit më parë nuk e kemi pasur. Kostoja e një institucioni arsimor duke reflektuar kështu investimet e realizuara të cilat synojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

përmirësimin e kushteve të punës mësues-nxënës është një element i rëndësishëm. Investimet janë realizuar 90% krasaur me planin.

Në sitemin rrugor-rural edhe pse kemi shtrirje të madhe kemi shtrirje në kufi me Devollin-Gramshin-Korçën, atë që dua të nënvizoja këtu wshtw pesha që kap buxheti i kësaj drejtorie edhe pse kemi një ndërthurrje me transfertën e kushtëzuar nga qeveria qendrore me fondet që i mbulojmë vetë nga të ardhurat tona, pasi nuk të mund të mbulohet vetëm me fondin e qeverisë, ka bërë të mundur që fondi të shkojë 6% të buxhetit, që është një shifër e konsiderueshme, vlera në mijë lekë shkon 57 milion lekë, realizmi faktik është 41%, por ajo çfarë thashë edhe këtu ka efekt likuidimi në kohë i faturave, për mirëmbajtje rruge, pagesa çakulli, për të cilat ne jemi munduar me Drejtorin e Rrugave në bashki në bashkëpunim me administrimin e njësive administrative t'i menaxhojmë në zonat ku ka më shumë probleme.

Peshën më të madhe e ze fondi i pagave pasi vetë shtrirja e sistemit rrugor-rural kap një sasi të madhe rrugore në km dhe kanë nevojë për fuqi puntore për çdo 3-4 km. Edhe këtu shpenzimet koherente dhe investimet, në vitin 2020 fakti është 47.148 mijë lekë dhe koherente janë 10.332 mijë lekë, në vitin 2019 ka qenë 26.041 dhe 20.275 d.m.th. rezulton me një rritje nga një vit më parë. Çka do të thotë që performanca po shkon në përmirësimin e duhur.

Në lidhje me ujin e pijshëm bashkia i ka dhënë një peshë të madhe, edhe pse flasim për një drejtori që është Sh.a. por me ndryshimet ligjore që qeveria ka bërë tashmë varet direkt nga bashkia, unë në rolin e Asamblesë së Aksionereve jam në mbikwqyrje të vazhdueshme, edhe investimet që ne kemi realizuar në rrjete të brendëshme, linja kryesore janë shumë të rëndësishme, po të shtojmë këtu edhe disa shpenzime koherente që ka bërë vetë drejtoria ka një përmirësim të dukshëm në furnizimin me ujë të pijshëm, por ende nuk jemi atje ku duhet. Investimet që po realizojmë gjatë këtij viti besoj do përmirësojnë dukshëm furnzimimin me ujë në shumë njësi administrative, në pjesën urbane uji ofrohet për 24 orë.

Shërbime të tjera që kanë të bëjnë me performancën e bashkisë, përvèç ujit që është thelbësor në punën tonë, po ju citoj që investimet janë dyfishuar në krasim me vitin 2019. Bashkia shpenzon një masë të konsiderueshme nga fondet e veta për këtë shërbim jetik për komunitetin. Dua të them disa fjalë për administrimin e pyjeve dhe kullotave edhe pse nuk jemi atje ku duhet në këtë shërbim, pasi pesha që ne kapim nga buxheti i bashkisë për këtë zë është vetëm 1%. Por edhe këtu kemi bërë një hap pozitiv në lidhje me regjistrimin e pyjeve dhe kullotave, është projekt i BB ndoshta mund të jemi një nga bashkitë pilot në rang republike që të gjitha pyjet, kullotat i kemi në sistem elektronik. Jemi gati për të nxjerrë certifikatat e pronësisë për çdo ngastër, parcelë e cila do të shërbejë për të siguruar të ardhura jo vetëm për buxhetin e bashkisë. Ka një rritje të numrit tw pemwve, ka rritje të numrit tw kontrollorwve për të siguruar fondin pyjor sipas kuadrit ligjor pasi ne kemi mungesë të planeve të menaxhimit, por nuk është vetëm mungesa e planeve por ka mungesë të pyjeve që kanë nevojë për shfrytëzim dhe kjo na ka bërë që një nga efektet për mosrealizmin e planit në bashki në masë të konsiderueshme ka te bëjw dhe sigurimi i të adhrurave dhe shpenzimeve nga drutë e zjarrit të popullatës ndaj edhe ky shërbim është kryer nga biznese që janë rrëth nesh si Erseka, Gramshi etj.



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

Unë ju falenderoj, kjo ishtë një përbledhje e Raporti të Performanës të Bashkisë, atë e keni dhe në versionin elektronik te faqja e bashkisë, jemi të gatshëm për çdo pyetje nga kumuniteti, falenderoj “Bashki të Forta” për ndihmën!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar! Ka ndonjë pyetje?

Pranvera Begolli: Ka patur një performancë të mirë bashkia!

Ornildi Demollari: Gjithë treguesit ishin në rritje, faleminderit Kryetar, falenderoj **dhe** “Bashki të Forta”!

Kalojmë te pikë tjetër e rendit të ditë! P-V “Për fillimin e procedurave të zhvendosjes së familjeve që jetojnë pranë ish-Komititetit dhe strehmit të tyre në godinën e ish-Laboratorit Qendoror si dhe përcaktimin e qirasë për çdo banesë dhe përbërjen familjare”;

Ka ndonjë pyetje ?

Pranvera Begolli: Përvendetje Kryetar! Duke pasur parasysh, shikoj edhe pjesën e tabelës të pwrbwirjes sw familjeve, shikoj që një familje me 4 anëtarë dhe pastaj shikoj ndarjen e banesave, nuk mund ta konceptoj dot që një familje me fëmijë të rritur si mund të jetojë në një apartament 1+1 dhe te numri i familjeve mungojnë 2 familje që janë me certifikatë pronësie, si do veprohet?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Vendimmarrja që kërkojmë sot është një miratim në parim që Sektori i Srehimit të fillojë procedurën dhe ju ka dhënë një informacion, por ne po i çojmë në kushte më të mira, ato janë disa godina për strehim social, janë pa të drejtë privatizimi, janë me qira minimiale dhe Drejtoria e Shërbimit Social të shikojë mundësinë dhe nëse gjen anën ligjore që familjet me ndihmw ekonomike ta kënë qiranë sa më të vogël mundësish të jetë zero nëse e lejon ligji, ndaj dhe sot kërojmë miratim në parim që drejtoria të fillojë këtë procedurën, Azemi Drejtori i Shërbimit Social të më korrigojë n.q.s. dhe në mbledhjen e radhës ose mbledhje jashtë radhe i diskutojmë emër për emër. Kjo është mundësia për momentin.

Pranvera Begolli: Po në të ardhmen si do veprohet me këto familje?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Çdo familje është i lirë të blerë hyrje te pallati që ne po ndërtojmë, ne po shikojmë mundësinë për politika të tjera të strehimit social apo ndërtime të tjera për familjet në nevojë, atje është zonë industriale dhe nuk mund ta kthejmë për strehim, por po e përdorim për emergjencë strehimi, pasi godina ku janë aktualisht është e pabanueshme, ndaj dhe vendimmarrja është ambient social stehimi pa të drejtë privatizimi. Familjet që kanë dokumenta nuk po i lëvizim, po i lemë atje. Ne po kërkojmë fonde nga ministri të ndryshme dhe godina për t'i kthyer për strehim social.

Pranvera Begolli: Edhe një problem tjetër, m.q.s. jam Administratore e Kombinatit, ndërtesa do kalojë në pronësi të Bashkisë apo të Entit të Banesave apo do vazhdojë që marrwdhënia e qirasë do jetë 50+50 me bashkinë?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Këto janë elementë teknike dhe besoj nuk duhet të janë pjesë e diskutimit të kësaj mbledhjeje. Shikon çfarë parashikoni ligji, këshilli mund t'i përdorë këto godina për strehim, nuk bëhet për të përfituar nga ato familje që janë në nevojë.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Pranvera Begolli: T'i propozohet këshillit që m.q.s. është në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshmë të marrë një vendim për qira minimale për këto familje.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Dua t'ju them që para se të marim një vendim duhet të bazohemi diku në ligj ndaj dhe drejtoria përkatwse të sjellë propozimin dhe këshilli e kalon, por duhet bazuar ligjërisht diku sa duhet të jetë qiraja, ku e mbështesin.

P/Sektorit të Strehimit z.Ledion Mullalli: Qiraja që po miratojmë sot është qiraja maksimale e cila është e mbështetur mbi VKM-në e qirave për banesat sociale, më vonë Këshilli i Bashkisë në momentin që do bëjmë strehimn faktik të familjeve në godinë, në bazë të hapwsirave ligjore mund të marrë vendime për familjet që janë në ndihmw ekonomike, mund t'i bëje deri në zero qiratë e tyre, ndërsa për familjet që janë me të ardhura të pakta mund të ulë qiranë në bazë të mundësisë që ata kanë.

Ornildi Demollari: Ledion mund ta marrim si vendim sot? Unë personalisht jam që qiratë të ulen të shkojnë në minimumin e lejuar.

P/Sektorit të Strehimit z.Ledion Mullalli: Sot jo.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Silleni vendmmarrjen të bazuar në ligj dhe këshilli e kalon, faleminderit!

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? File ke diçka?

File Qyrani: Po doja të dija është bërë kontakt me familjet për dakortësinë e tyre?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Godina për të cilën flasim është e pabanueshme dhe ndoshta këto familje t'i kishim lëvizur më parë që atje. Ata çdo ditë na kërkojnë kur do na kaloni nga kjo godinë në një të re, pasi ndryshimi është si nata me ditën, kemi pasur konakte kemi bërë analizën e personave për çdo kurorë. Familjet janë të kënaqura që po ikin nga ajo godinë.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë problem tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online. Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditë! P-V “Për rishikimin e buxhetit të bashkisë viti 2021”. Ka ndonjë pytje? Kryetar...

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Është një ndryshim i vogël për blerjen e një parangoje përfket të funksionimit të Kaskadës së Zëmlakut përfket të vaditjes që ajo na ka kaluar si pronw ne me VKM, është një vlerë 150.000 lekë është brenda fondeve tw zërave.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online, Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditë! P-V “Për miratimin e Raporit të Monitorimit 4-mujor, viti 2021”. Ka ndonjë pyetje? Kryetar...

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Nëse këshilltarët kanë diçka, në të gjitha zërat jemi më shpjet se çdo vit tjeter.

Ornildi Demollari: P ozitiv ishte fakti dhe këtu krahasaur me vitin 2020, të ardhurat janë në rritje, e kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online, Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditë! P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2021 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës të bashkisë dhe strukturat e saj, për vitin 2021”, kryetar?

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Janë disa rregullime të pagave në Drejtoria e Ujtje-Kullimit, kemi bërë një shtesë për disa punonjës që pagueshin me 6 orë kalojnë me 7 orë, kemi bërë një rregullim të pagave midis ekskavatoristve dhe ndihmwsave mos janë të barabartë në pagë, kemi bërë një rregullim të pagës së dy drejtoreve të Shërbimit Social dhe Pyjor pasi kanë pasur një përmirësim të performancës, pasi objektivat dhe qëllimet tona kanë ndryshuar për të bërë një reformim të plotë të administratës të bashkisë. Kemi krijuar një sektor të ri Sektori i Rekreacionit dhe Turizmit që nuk e kemi pasur deri tani, duam që të kemi një strukturë me 3 punonjës përfshirë aktivitetet turistike, kulturore, duam që shumë shpjet të kemi një dokument bazë me gjithë pikat e vizitueshme në bashki. Kemi bërë shtesë përfshirë një shofer në Njësianë Administrative Moglicë, nuk kemi pasur pasi nuk kemi pasur mjet, pasi e siguruam një mjet nga Sh.a. e mbetjeve të Qarkut Korçë ka shumë punë në këtë zonë ndaj po bëjmë edhe shtesën. Do i kërkoja këshillit të shikojmë dhe një Inxhinier Ndërtimi përfshirë projektet dhe gjithë pjesa tjeter është ok.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjeter?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online. Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, me ndryshimet e kërkuarë shtesë, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditë! P-V “Për miratimin e Dokumentit të Vlerësimit të Riskut në Bashkinë Maliq si dhe Strategjinë Operacionale përfshirë Zvogëlimin e Rriskut nga fatkeqësitë”.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Ky është një detyrim ligjor të cilin ne e miratojmë çdo vit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër? Inxhinier Idlir ke ndonjë pyetje?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online.

Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për vendoşjen e emrit të shkollës së fshatit Zerec “Shaban Maranaku” (Zereci), shkollës së fshatit Popçisht “Shahin Matraku” dhe vendoşjen e bustit në qendër të fshatit Moglicë të “Hasan Bardhit” (Moglica).

Pranvera Begolli: Kryetar me lejë, me këto vendime Këshilli i Bashkisë është njohur më parë, kërkuam që komuniteti të ishte pjesëmarrës në vendim dhe u realizua, kështuqë objektivi u përmbrush dhe t'i miratojmë, t'i gjelqojnë nxënësit emrat.

Ornildi Demollari: Na ka ardhur sot një P-V nga Njësia Administrative Pojan bashkë me dokumentacion shoqëruar për vendoşjen e emrit të shkollës së fshatit Rrëmbec “Dhimitraq Gjata” emri kështu është por nuk ka vendim.

Pranvera Begolli: Për mua të miratohet dhe kjo, “Dhimitraq Gjata” ka qënë një nga dëshmorët e Pojanit.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim Moglicën?

Kush është dakord?

Kundra? Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga këshilltarët online.

Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Tani kalojmë Rrëmbecin, kemi dokumentacion të bollshëm nga bordi i prindërve, pleqësia e fshatit, P-V nga Njësia Administrative Pojan me firma, do doja ta marrim në shqyrtim dhe ta kalojmë.

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga Këshilltarët online.

Miratohet pika e tretë me 20 vota pro, Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, informacion mbi rezultatet e Konsultimit Publik online për përcaktimin e prioriteteve të Komunitetit të PBA-sw 2021-2023.

Po ju lexoj një material për këtë pikë,

Fushata e partneritetit të këshillit me qytetarin

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Maliq, gjen rastin të komunikojë në këtë mbledhje, Informacionin për “**Fushatën e partneritetit të këshillit me qytetarin**” e cila ka për qëllim të sjellë më afër qytetarin tek keshilli bashkiak.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mënyra se si kjo propozohet të arrihet (duke kapërcyer një numër veshtirësish që lidhen me distancat, kohën apo burimet e kufizuara financiare) është perms pranisë dhe urave virtual të këshillit me komunitetin: në dispozicionin të Këshillit janë vënë një numër instrumentash që mundësojnë konsultimin e qytetarit për çështje që lidhen me buxhetin bashkiak, ofrimet e shërbimeve publike dhe integrimin e politikave gjinore në to.

Cilat janë këto platforma/instrumenta që na sjellin më pranë qytetarëve:

- **Ndërtimi I ndërsaçës së Këshillit** në webin e Bashkisë, ku qytetarët mund të informohen mbi aktivitetin e Këshillit dhe Komisioneve (përfshinjë plan të detajuar për përmirësimin e tyre).
- **Facebook-u i Këshillit Bashkiak (fanpage)**, ku mund të ndiqni mbledhjet LIVE të Këshillit Bashkiak dhe bëhenipjesë me komentet tuaja.

Në ndërsaçen e Këshillit Bashkiak si pjesë e web-it të bashkësisë qytetarët do të kenë mundësi të ndërveprojnë përmes:

1. **Sondazhi përprioritet e buxhetit**: qytetarët informohen mbi arritjet e bashkisë, mbajtjen e angazhimeve dhe mund të shprehin parapëlqimet/prioritet e tyre për buxhetin 2022;
2. **Formulari përkërkesa, ankesa, nisma qytetare apo peticione** adresuar këshillit bashkiak: në mënyrë transparente publikohet ndjekja dhe realizimi i tyre në regjistrat përkatës, që janë të publikuara në këtë ndërsaçë.
3. **Regjistrat e konsultimeve me publikun** që prezantojnë në mënyrë transparente përpjekjen e Këshillit për të përfshirë qytetarët në vendim-marrje. (jane gati per t'u hedhur ne faqen e Këshillit)
4. **Numrat/kontaktet e Këshilltarëve** të cilët përfaqësojnë interesat e komunitetit tuaj nëvendimarrjen vendorenjëmundësiqëjutëkomunikonidrejtëpërdrejtë me ta

Për sa më sipër, Këshilli angazhohet për një fushatë informuese e ndërgjegjësuese pjesë e së cilës do të jetë:

1. **Spot me në qendër partneritetin Këshill-Qytetar** dhe instrumentat që e mundësojnë atë.
2. **Takime të hapura me publikun** për të demonstruar kanalet e komunikimit në dispozicion të këtij partneriteti dhe marrë konsiderat e qytetarëve për hapat e mëtejshëm.

Në përpjekjet tona për të qenë më pranë qytetarëve, **Këshilli Virtual** është një mundësi e re në përputhje me Axforden Dixhitale. Në këtë përpjekje, Këshilli ynë asistohet nga Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë me mbështetjen e Bashki të Forta, një project i Qeverisë Zviciane.

Duke qenë se jemi në fazën e aprovimit të raportit të buxhetit dhe përgatitjes së buxhetit 2022, do të donim që përvëç elementëve bazë të project vendimit për **Fushatën e partneritetit të Këshillit me Qytetarin** (dokumenti i projektvendimit dhe plani i aktivitetit, do te sillen per miratim ne mbledhjen e ardhshme), të ndanim me ju instrumentin e **Sondazhi përprioritet e buxhetit**.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Ky sondazh jep informacion mbi mënyrën si janë shpenzuar fondet publike gjatë vitit 2020. Ai i jep mundësi komunitetit të rekomandojë shërbimet prioritare për vitin e ardhshëm 2022. Informacioni bazohet në të dhënat e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020.

Ai përbën një nga pikëni jet që Këshilli Bashkiak përdor për të zgjeruar dialogun me qytetarët në lidhje me çështje të rëndësishme, sikurse buxheti dhe është publikuar në hapesirat tona virtual si webi i bashkisë dhe në faqen e Facebook-ut të këshillit bashkiak.

Kanë plotësuar pyetsorin 188 persona të komunitetit të bashkisë Maliq nga të cilët 100 meshkuj dhe 88 femra në një raport 53% me 47%. Ndërsa 71% e kanë vizituar / lexuar Buxhetin interaktiv të Raportit të Performancës 2020 (elektronik) dhe e vlerësojnë informacionin që ai jep si;

Mjaft të dobishëm (duke I dhënë notën 4,46 nga 5 maksimumi).

Deri tani, mendohen si prioritarw nga qytetarwt:

- Shërbimet Bujqwsore
- Strehimi
- Arsimi i Meswm
- Sport dhe Argwtim
- Trashwgimia Kulturore
- Pyjet dhe Kullotat

Plotësimi i sondazhit vazhdon deri nw nwntor 2021.

Personalisht e kam postuar linkun e sondazhit në profilin tim në Media Sociale dhe do të vazhdoj t'a ripostoj çdo ditë në mënyrë që miqtë e mi të FB apo ndjekësit dhe gjithë anëtarët e komunitetit të informohen për këtë instrument të rëndësishëm.

Edhe njëherë i bëj thirrje qytetarëve të përdorin të drejtën e tyre të përfshirjes në vendimarrje duke mbushur këtë pyetësor. Mbushja e pyetwsorit gjatë kësaj faze mundëson përfshirjen e kërkesave në një dokument me rekondime për administratën. Presim që administrata të reflektojë ndryshime në buxhet si rezultat i kërkesa vetë komunitetit (sigurisht Brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore.).

Gjithashtu i bëjthirrje qytetarëve të plotësojnë kontaktet e tyre në pyetësor që të kemi mundësi t'i informojmënë lidhje me konsiderimin e kërkesave/propozimeve të tyre në Buxhetin 2022. Le të marrim një minute kohë për të testuar plotësimin e sondazhit në linkun që kam ndarë me ju. Një të njëjtën kohë ju ftoj ta ndani këtë link në rrjetet tuaja (what's up, fb dhe instagram)

Ju Faleminderit!

Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditës, informacion mbi gjetjet e anketimit për punën e kryer nga Këshilli Bashkiak gjatë vitit 2020. Rezultatet e anketës mbi realizimin e punës së Kwshillit Bashkiak Maliq gjatë vitit 2020.



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

Në këtë anketë të zhvilluar online morën pjesë gjithsej 82 persona, pjesa më e madhe e anketuesëve ishte meshkuj (58%) dhe mosha qe u ishte përgjigjur me shumë pyetjeve nga 26-40 vjeç.

89% e të anketuarëve e njohin rolin e Këshillit Bashkiak, dhe 85% e tyre njohin gjithashtu këshilltarin që i përfaqëson në këshill, një tregues pozitiv ky përsa i përket rolit të këshilltarëve të cilët kanë qënë prezentë në terren dhe kanë adresuar problematikat e qytetarëve në këshill.

Për tu theksuar është transparenca e këshillit, ku 82% e të anketuarëve kanë ndjekur online mbledhjet e këshillit dhe kanë vlerësuar këtë fakt. Në bashkëpunim me Bashki të Forta, Këshilli i Bashkisë Maliq prej 1 viti transmeton online mbledhjet e këshillit duke ju dhënë mundësi banorëve t'i ndjekin dhe të shprehin kërkesat/ankesat e tyre apo dhe të organizohen nëpërmjet nismave dhe peticioneve.

Mbi 90% e të ankimuarve ndjekin faqen e Këshillit Bashkiak në rrjetet sociale dhe shumica prej tyre e vlerësojnë pozitivisht publikimin e vendimeve të këshillit. Pozitivë shprehen edhe per trajtimin e kërkesave dhe ankesaver të tyre, ku mbi 60% kanë marrë përgjigje në kohë.

Shumica e të anketuarëve vlerëson transparencën e këshillit (85%), punën e këshilltarëve, trajtimin e kërkesave dhe ankesave në kohë si dhe çka është arritur deri tani në pjesën e komunikimit online.

Fakti që 85% e të ankimuarëve vlerësojnë pozitivisht punën e realizuar nga Keshilli Bashkiak Maliq gjatë vitit 2020,na bën të ndihemi krenarë dhe të punojmë më tepër për të sjellë zérin e qytetarëve, për të ngritur problematikat e tyre dhe për t'i përfaqësuar ata denjësisht.

Kalojmë te pika tjeter e rendit të ditës, “Për miratimin paraprak të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Maliq”;

Përfaqësuesi i Bankës Botwrore si financuese e projektit jep informacion të hollësishëm për materailin para se të kalohet në votim.Të nderuar Këshilltarë kam kënaqësinë tju them që në rang kombëtar Bashkia është e vëtmja që ka përfitaur nga kjo projekt, falenderoj Bashkinë Maliq për bashkëpunimin e realizimit të palnit të mbashtrimit.

Ka ndonjë problem tjeter?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 10 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 10 vota nga Këshilltarët online, Miratohet pika e tretë me 20 vota pro.

Faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI